

**EXPOKOS***Porta e Ballkanit!***PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**ufi  
Approved  
Event**INFORMATAT E PËRGJITHSHME****Afati i fundit për konfirmim: 28 Prill 2023****INFORMATAT E PANAIRIT****Forma- A**

Emri i Panairit	EXPOKOS - Edicioni i 22-të
Profili i Panairit	Ndërtim, Energji, Teknikë, Makineri, Mbrojtje dhe Siguri
Data	18-19 Maj 2023
Vendi	Pallati i Rinisë - Prishtinë
Panairi organizohet	Një herë në vit
Hapësira ekspozuese	20000m <sup>2</sup>
Kategoria e vizitorëve	Profesional, Tregtarë dhe Publik
Shitje direkte	Po
Ngjarjet paralele	Konferenca, Takime B2B, seminare dhe prezantime të kompanive

**AGJENDA**

AGJENDA	DATA	KOHA
Vendosja e ekspozuesve	16 maj 2023	15:00-21:00
Vendosja e ekspozuesve	17 maj 2023	08:00-20:00
<b>Hapja zyrtare</b>	<b>18 maj 2023</b>	<b>10:00</b>
<b>Koha e ekspozitës</b>	<b>18 maj 2023</b>	<b>10:00-18:00</b>
<b>Koha e ekspozitës</b>	<b>19 maj 2023</b>	<b>10:00-18:00</b>
Tërheqja e ekspozuesve	19 maj 2023	18:00-21:00

**AFATET**

PËRSHKRIMI:	AFATET
Afati i fundit për konfirmim si ekspozues	28 prill 2023
Afati i fundit për porositjen e standës te organizatori (nëse ju duhet)	28 prill 2023
Afati i fundit për dërgimin e të dhënave/dizajnit tuaj për publikim në katalogun e panairit	02 maj 2023
Afati i fundit për porositje të pajisjeve shtesë (nëse ju duhen)	03 maj 2023
Afati i fundit për porositje nga paketa sponsoruese (nëse ju duhen)	03 maj 2023
Afati i fundit për rezervimin e dhomës së prezantimeve (nëse ju duhet)	03 maj 2023
Afati i fundit për dërgimin e profaturës për Import/Export të përkohshëm (nëse keni nevojë)	03 maj 2023
<b>Organizator:</b>	CEO-Congress & Event Organization
<b>Adresa:</b>	Rr. Emrush Miftari - nr.14, 10000 - Prishtinë - Kosovë

Tel: +383 38 516 013, +383 44 208 446, e-mail: info@ceokos.com, web: www.ceokos.com

**EXPOKOS***Porta e Ballkanit!***PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**ufi  
Approved  
Event**GRUPET E PRODUKTEVE NË PANAIRIN EXPOKOS**

Emri i kompanisë: \_\_\_\_\_

**Forma- B**\*Vërejtje: Ju lutem shënoni me **X** profilin e kompanisë tuaj apo shënojeni profilin në hapësirën "tjetër" nëse nuk mund të gjeni profilin e kompanisë në listë.**• Ndërtim:**

- Materiale ndërtimore
  - Sisteme dhe pajisje ndërtimi
  - Produkte kimike industriale
  - Izolime, Ngrohje
  - Instalime elektrike
  - Sanitari, Qeramikë
  - Dyer dhe dritare
  - Përpunim i metaleve
  - Ndërtime të brendshme dhe Dekorime
  - Fasada dhe ndërtime prej qelqi
  - Gurë natyral
  - Ashensorë
  - Riciklime
  - Metale të ndryshme
  - Mobileje shtëpiake dhe për zyre
  - Makineri për përpunimin dhe prodhimin e mobiljeve
  - Ndërtim të rrugëve
  - Ndriçime të rrugëve dhe parqeve
  - Kuzhina, Teknikë shtëpiake, Mobilje banjo
  - Parket, Dekorime të drurit
  - Sisteme banimi nga druri, Kamp-shtëpiza nga druri
  - Institucione Bankare
  - Kompani të paluajtshmërive
  - Kompani të Inxhinierisë dhe ndërtimtarisë
  - Kompani mjedisore
  - Kompani të investimeve dhe planifikimeve
  - Kompani projektuese dhe disenjatorë
  - Kompani të Planifikimeve urbane
  - Kompani sigurimesh
- Tjetër \_\_\_\_\_

**• Makineri:**

- Pajisje për kontrollim të kualitetit
  - Instrumente dhe makineri matëse
  - Aparaturë analitike, Automatikë dhe robotikë
  - Pajisje hidraulike
  - Pajisje të metaleve dhe jo-metaleve
  - Makineri dhe pajisje industriale
  - Pajisje për kontrollim të kualitetit
  - Instrumente dhe makineri matëse
  - Aparaturë analitike, Automatikë dhe robotikë
  - Pajisje hidraulike
  - Pajisje të metaleve dhe jo-metaleve
  - Makineri dhe pajisje industriale
- Tjetër \_\_\_\_\_

**• Mbrojtje dhe siguri:**

- Sistem të kontrollit të qasjes
  - Teknologji biometrike
  - Sisteme të Menaxhimit të Ndërtesave
  - Planifikim dhe konsulenca për vazhdimësinë e biznesit
  - Certifikim dhe kontroll të cilësisë
  - Komanda, kontrolli, komunikimi & rrjeti informativ (C3I)
  - Sigurim komercial dhe rezidencial
  - Sisteme të mbikëqyrjes digjitale
  - Siguri të dokumenteve
  - Sisteme të alarmeve emergjente dhe të paralajmërimit
  - Menaxhim të eksplozivëve dhe pajisjet
  - Sisteme për monitorimin e patrullimit të rojeve
  - Kasafortat & Dhomat për ruajtjes
  - Siguri të harduerit
  - Pajisje dhe sisteme të identifikimit
  - Siguri të informacionit dhe rrjeteve
  - Pajisje dhe sisteme për zbulimin e ndërhyrjeve
  - Lente dhe ekranet LCD
  - Sisteme për vëzhgimin e rrjeteve
  - Siguri në paketim, lëvizje dhe ruajtje
  - Siguri të perimetrit
  - Pajisje për mbrojtje personale
  - Siguri të shitjes më pakicë
  - Vlerësim të rrezikut
  - Ekzaminim dhe inspektim
  - Aplikacione të sigurisë për ndërtesa
  - Xham & mbështjellje sigurie
  - Ndhima në simulim & trajnim
  - Tekstile speciale
  - Shërbime të vëzhgimit dhe ruajtjes
  - Programe & pajisje të telekomunikacionit
  - Menaxhim të kërcënimeve
  - Pajisje dhe sisteme të gjurmimit
  - Shoqata tregtare, këshille & institucione
- Tjetër \_\_\_\_\_

**• Energji:**

- Kompani projektuese dhe disenjatorë
  - Kompani të Planifikimeve urbane
  - Kompani sigurimesh
  - ndustrinë e energjisë elektrike
  - Energji alternative nga: Era, Uji, Dielli dhe Gasi
  - Stacione dhe baza të derivateve
  - Ministri dhe institucione hulomtuese- në energjetikë
  - Miniera dhe minerale, Shkritore
  - Makineri për thërrmim dhe përpunim të mineraleve
  - Makineri për hapjen e korridoreve në miniera
  - Makineri për shpuarje
  - Makineri për transportim të mineraleve
  - Vegla pune dhe pajisje sigurie për miniera
- Tjetër \_\_\_\_\_



**EXPOKOS**

*Porta e Ballkanit!*

**PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**



**ufi**  
Approved  
Event

**FORMULARI PËR KONFIRMIM TË PJESËMARRJES**

**Ju lutem plotësojeni dhe dërgojeni prapa tek CEO**

**Forma- C**

**Emri i Kompanisë Ekspozuese:**

Adresa:

Tel:

e-mail:

web:

Personi kontaktues:

Pozicioni:

Emri i Kompanisë suaj për vendosje në Stendë dhe në Certifikatë:

**1. Shënoni profilin e kompanisë/institucionit tuaj:**

*Obligative për çdo Ekspozues*

**2. Çfarë produkte planifikoni të ekspozoni në panair? Ju lutem listoni ato më kryesoret.**

**3. A keni ndonjë produkt/shërbim risi për tregun e Kosovës apo më të veçantë se produktet aktuale që janë në treg e të cilin planifikoni ta ekspozoni në panairin EXPOKOS?**

**4. Cilat janë grupet e klientëve tuaj? Kënd keni interes saktësisht ta takoni në panair?**

**5. Kush janë konkurentet e kompanisë suaj? A mund të na i listoni disa? (është konfidenciale, shërben vetëm për informacion të brendshëm)**

**6. Për çfarë përkrahje ka nevojë kompania juaj nga qeveria e Kosovës? (kjo pyetje është vetëm për kompani vendore)**

Qëllimi i vetëm këtyre pyetjeve është që ta kuptojmë më tepër kërkesën/qëllimin e pjesëmarrjes së kompanisë së tuaj në panair, në mënyrë që ti oftojmë sa më shumë klientët potencial të cilët ju mund të keni interes ti takoni në panair.

**Tel: +383 38 516 013, +383 44 208 446, e-mail: info@ceokos.com, web: www.ceokos.com**

**EXPOKOS***Porta e Ballkanit!***PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**ufi  
Approved  
Event**FORMULARI PËR KONFIRMIM TË PJESËMARRJES****Ju lutem plotësojeni dhe dërgojeni prapa tek CEO****Forma- D****1. Regjistrimi për ekspozim:***Obligative për çdo Ekspozues*

70 €

Përfshirë në çmim: ID/bexhi për ekspozuesin si dhe publikimi i të dhënave bazë të kompanisë ekspozuese, si : Emri i kompanisë, telefon, e-mail, web, adresë.

**2. Hapësira e zbrazët ekspozuese:****Ju lutem nënvizojeni njërën prej fushave që ju përgjigjet:** 

Nënvizojeni në katror <input checked="" type="checkbox"/>	Hapësira - m <sup>2</sup>	Çmimi për m <sup>2</sup>	Shuma
<input type="checkbox"/> Hapësira në radhë ( një anë e hapur )		65 € /m <sup>2</sup>	
<input type="checkbox"/> Hapësira në kënd ( dy anë të hapura )		65 € +10 % m <sup>2</sup>	
<input type="checkbox"/> Hapësira ballore ( tri anë të hapura )		65 € +15 % m <sup>2</sup>	
<input type="checkbox"/> Hapësira bllok ( katër anë të hapura )		65 € +20 % m <sup>2</sup>	

**Shërbimet e përfshira në çmim vetëm për hapësirën e zbrazët - pa standë:**

Hapësira ekspozuese, një prizë e rrymës dhe kyçja në internet.

**3. Ndërtimi i standës standarde - A:***Shiqo formën - F*Çmimi i standës: 25 € për m<sup>2</sup> x \_\_\_\_\_ m<sup>2</sup>

Përfshirë në çmimin e pakos me standë: Hapësira ekspozuese, ndërtimi i standës me profile alumini dhe ndarje të bardha - Sistem Octanorm, tavolinë informative - infodesk, tavolinë me 3 ulëse, tepih, ndriçim, mbishkrimi i kompanisë suaj në standë - tekst standard, një prizë e rrymës, shporta e mbeturinave dhe kyçja në internet.

**4. Ekspozimi në ambient të hapur:**

	m <sup>2</sup> / sasia	Çmimi për m <sup>2</sup>	Shuma
Hapësira e zbrazët ekspozuese		35 € /m <sup>2</sup>	

Përfshirë në çmim: hapësira e zbrazët ekspozuese me nje tavloine dhe 3 karrige

**5. Tendat:** *Shiqo formën - F*

	Njësi / sasia	Çmimi për njësi	Shuma
Tendë e mbuluar me mbyllje anësore sipas dëshirës (5 x 5m)		350 € për copë	

**6. Veshja e mureve të standës me folje vetë-ngjitëse :**

Çmimi i foljes vetë-ngjitëse : 15 € për m <sup>2</sup> x _____ m <sup>2</sup>	Një mur/panojë e standës i ka 2.4m <sup>2</sup>	Shuma

**Përfshirë në çmim: Printimi, montimi dhe demontimi i foljeve vetë-ngjitëse.**

Për ta porositur dhe shfrytëzuar këtë shërbim, çdo kompani ekspozuese është e obliguar që ta dërgoj të gatshëm dizajnin.

Dizajni i materialeve për print duhet të jetë me përmasa të sakta në bazë të dimensioneve të standës apo hapësirave që preferoni ti vendosni foljet vetë-ngjitëse. Tek forma E pika e 14 mund ta shihni pamjen e një stente me folje vetë-ngjitëse.

Përshkrimi	Gjerësia	Lartësia	Thellësia
Paneli	0.95.5 m	2.39 m	
Emri i Kompanisë	1.95 m	0.18 m	
Info desk	0.80 m	0.98 m	0.38 m
Rafti në muri	1.00 m		0.30 m
Stenda komplet	x	2.50 m	x

**7. Promovimi në katalog, në faqe të Facebook dhe Instagramit dhe web faqe të panairit:**

	Shuma
<b>Materialet e kërkuara duhet të dërgohen 3 deri në 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës</b>	70 €

Për katalog të panairit përdoren të dhënat dhe teksti që e shkruani tek profili i kompanisë suaj.

Për promovim në FB dhe Instagram page duhet të na dërgoni një **dizajn të gatshëm me dimensione katrorë** të përshtatshëm për publikim në rrjete sociale.

Të gjithë ekspozuesit që do jenë pjesë e panairit EXPOKOS do të publikohen në katalogun e panairit, në rrjetet sociale në faqet zyrtare të FB në Instagram dhe në web faqe të Panairit EXPOKOS.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është promovimi i kompanisë/institucionit tuaj, njëkohësisht edhe njoftimi i vizitorëve për pjesëmarrjen e kompanisë/institucionit tuaj në panairin EXPOKOS.

Ju njoftojmë se publikimi i postit tuaj në faqet zyrtare të FB dhe Instagram të Panairit EXPOKOS, nga momenti kur do publikohet do të paguhet (bëhet boost) nga organizatori i panairit, pra nga CEO.

**EXPOKOS***Porta e Ballkanit!***PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**ufi  
Approved  
Event**FORMULARI PËR KONFIRMIM TË PJESËMARRJES****Ju lutem plotësojeni dhe dërgojeni prapa tek CEO****Forma - E****8. Elementet shtesë dhe shërbimet tjera:**

Artikulli	Sasia	Çmimi/njësi	Shuma
Info desk (0.80 x 0.98 x 0.38 cm)		35 €	
Vitrinë e gjatë nga qelqi (40 x 40 x 180 cm)		40 €	
Rafte (1 x 1m gjatësi)		15 €	
Kabinë brenda standës		50 €	
Tavolinë		10 €	
Ulëse		3 €	
Kyqje të ujit në standë me enëlarës		250 €	
Kyqje të prizave shtesë		10 €	
Kablo vazhduese e rrymës		10 €	
Reflektorë ndriçues		20 €	
Kyqje e rrymës mbi 4 kW		100 €	
Frigorifer në shfrytëzim		50 €	
LCD TV		250 €	
DVD		20 €	
Mbajtëse e broshurave		30 €	
Vazo me lule		25 €	
Printimi dhe vendosja e logos në pjesën e sipërme të standës		35 €	
Printimi dhe vendosja e logos në info desk		35 €	
Varëse për garderobë		25 €	
Tepih		5 €/m <sup>2</sup>	
Salla e konferencave/prezantimeve		100 €/orë	
Tjetër:			

**9. Kostoja për import/export të përkohshëm (nëse keni nevojë):****Totali 4**

Shërbimet e Bankës për garancion bankar	Shërbimet e kompanisë shpeditere	Shuma
100 €	150 €	

**Gjithsej shërbimet e Bankës dhe të kompanisë shpeditere për import/eksport të përkohshëm = 250 €***Për më shumë shiqo formën - G***SHUMA TOTALE****Totali 1+2+3+4+5+6+7+8+9****+18 % TVSH****Shuma përfundimtare****10. Forma e rezervimit të pjesëmarrjes:**

Rezervimi për pjesëmarrje mund të bëhet përmes plotësimit të formularit dhe dërgimit me e-mail-it ose direkt gjatë takimeve me stafin e CEO-s. Kontrata në mes të ekspozuesit dhe organizatorit të ngjarjes do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

**11. Pagesa:** Pagesa e plotë me pranimin e faturës.**12. Sqarim:** a) Në rast se ekspozuesi tërhiqet nga pjesëmarrja në panair në afat brenda 10 ditësh pas nënshkrimit të marrëveshjes, ekspozuesi obligohet ndaj organizatorit të panairit me shumën prej 50% të shumës totale sipas marrëveshjes.

Ndërsa në rast se tërheqja bëhet 10 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes/formularit të rezervimit, ekspozuesi obligohet ndaj organizatorit të panairit me shumën totale sipas marrëveshjes.

b) Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga kjo kontratë, apo është në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose jo-vlefshmërinë e kontratës, do të zgjidhet në bazë të ligjeve në fuqi, duke ju drejtuar përmbaruesit ose në rast nevojë gjykatës kompetente në Kosovë dhe/ose gjykatës kompetente nga shteti i origjinës nga vjen kompania ekspozuese.

Organizatori mbanë të drejtën ekskluzive në përzgjedhjen e gjykatës.

**Ne pajtohemi me termet dhe kushtet e përgjithshme të Panairit**

Organizatori i Panairit, CEO - Congress &amp; Event Organization

Kompania Ekspozuese

Nënshkrimi / Vula	Data:

Nënshkrimi / Vula



EXPOKOS

Porta e Ballkanit!

PANAIRI NDËRKOMBËTAR

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

22  
VITE




ufi  
Approved  
Event

**SHEMBUJ TË STENDAVE DHE ELEMENTEVE TJERA**

Ju lutem shënojeni emrin e Kompanisë suaj (ashtu si dëshironi ta vendosim në standën tuaj) :


**Forma- F**

13. Stenda standarde - A (një anë e hapur)




Përshkrimi	Gjerësia	Lartësia	Thellësia
Paneli	0.95.5 m	2.39 m	
Emri i Kompanisë	1.95 m	0.18 m	
Info desk	0.80 m	0.98 m	0.38 m
Rafti në muri	1.00 m		0.30 m
Stenda komplet	x	2.50 m	x

13a. Stenda standarde - A (dy anë të hapura)




14. Brendimi / veshja e mureve të standës me folje vetë-ngjitëse, sipas kërkesës së klientit (dizajni duhet të përgatitet nga kompania ekspozuese) :



Përshkrimi	Gjerësia	Lartësia	Thellësia
Paneli	0.95.5 m	2.39 m	
Emri i Kompanisë	1.95 m	0.18 m	
Info desk	0.80 m	0.98 m	0.38 m
Rafti në muri	1.00 m		0.30 m
Stenda komplet	x	2.50 m	x


15. Tendë e mbuluar, me mundësi mbyllje/hapje anësore




16. Vitrinë e gjatë




17. Mbajtëse e broshurave




18. Raftë në standë



19. Info desk



20. Tavolinë



21. Ulëse





**EXPOKOS***Porta e Ballkanit!***PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**ufi  
Approved  
Event**TERMET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PANAIKIT****1. Regjistrimi:****Forma- G**

Rezervimi për pjesëmarrje bëhet duke përdorur Formularin e Rezervimit. Afati i fundit për rezervimin e pjesëmarrjes në Panair publikohet në Formularin e Rezervimit. Rezervimi mund të bëhet duke dërguar të plotësuar Formularin e Rezervimit përmes faksit, postës, e-mailit ose drejtpërdrejtë në zyrat e CEO-së. Kontrata në mes të ekspozuesit dhe organizatorit të ngjarjes do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

**2. Agjenda e panairit:**

Agjenda e panairit përfshirë: montimin, kohën e ekspozitës dhe demontimin publikohet në Formularin e Rezervimit.

**3. Pranimi i ekspozuesve:**

Organizatori ka të drejtë refuzimin e aplikantit për ekspozim në bazë të mungesës së kapaciteteve hapësinore dhe nëse nuk përshtatet me programin e panairit të përcaktuar nga organizatori. Ekspozuesi do t'i ofroj organizatorit informatat për kompaninë e tij/saj dhe produktet që do të ekspozohen. Nëse ekspozuesi ka për qëllim të ekspozoj produkte tjera të cilat nuk janë të përfshira në programin e ekspozimit apo që mund t'i takojnë plotësisht sektorëve tjerë, atëherë organizatori rezervon të drejtën që të anuloj pjesëmarrjen e tij në panair.

**4. Tarifat e pjesëmarrjes:**

Organizatori do të tarifoj një herë për secilin ekspozues tarifën e regjistrimit, hapësirën ekspozuese, standën, publikimin në katalogun e panairit dhe shërbimet tjera të kërkuara nga klienti.

Tarifat e pjesëmarrjes, llojet e standave dhe shërbimet tjera me çmime, janë të publikuara në Formularin e Rezervimit.

**5. Aranzhimi i hapësirës ekspozuese:**

Organizatori i panairit do të ndajë hapësirën e ekspozimit dhe do të përcaktojë vendndodhjen e secilit ekspozues. Ekspozuesi do të konfirmoj propozimin e bërë nga organizatori, pasi që të bëhet ky konfirmim organizatori nuk rezervon asnjë të drejtë të ndrrimit të vendit të ekspozuesit pa miratimin e tij. Stendat e përbashkëta lejohen. Për çdo bashkë-ekspozues të ri brenda standës duhet të merret aprovimi nga organizatori.

Organizatori rezervon të drejtën të aplikoj tarifë shtesë për secilin bashkë-ekspozues.

**6. Dizajni dhe ndërtimi i standës:**

Ekspozuesit kanë mundësi të porosisin dizajnin dhe konstruktimin/ndërtimin e standës së tyre përmes organizatorit me koston e publikuar në Formularin e Rezervimit. Ekspozuesi mund të dizajnoj, montoj, përshtatë dhe çmontoj standën e vet me kosto të tij përmes kompanive tjera të ndërtimit të standave. Secila standë në hapësirën e ekspozimit do të ketë numrin e vet dallues të standës dhe emrin e ekspozuesit.

Organizatori ka të drejtën ekskluzive që të mos aprovij konstruktimin e standës nëse ajo nuk është e bazuar në standardet ndërkombëtare (nëse konstruksioni nuk është i licencuar, apo nëse konstruksioni nuk është mjaft stabil, apo nëse lartësia e standës është më e lartë se lartësia adekuate e sallës).

**7. Anulimi i marrëveshjes:**

Në rast se ekspozuesi tërhiqet nga pjesëmarrja në panair në afat brenda 10 ditësh pas nënshkrimit të marrëveshjes, ekspozuesi obligohet ndaj organizatorit të panairit me shumën prej 50% të shumës totale sipas marrëveshjes.

Ndërsa në rast se tërheqja bëhet 10 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes/Formularit të rezervimit, ekspozuesi obligohet ndaj organizatorit të panairit me shumën totale sipas marrëveshjes. Kushtet e anulimit gjithashtu janë të përfshira në Formularin e Rezervimit.

**8. Shërbimet e pastrimit:**

Organizatori përkujdeset për pastrimin e standave dhe hapësirës ekspozuese pas mbylljes së kohës së ekspozimit.

Mbeturinat e krijuara nga ekspozuesit gjatë montimit të standës, kohës së ekspozimit dhe gjatë demontimit të standës duhet të largohen nga vetë ekspozuesi.

**9. Siguria:**

Kompanitë janë të obliguara që të jenë prezentë në vendin e tyre nga ora 08:00 deri 20:00 gjatë largimit apo vendosjes së standës. Ndërsa gjatë ditëve të ekspozimit ato janë të obliguara të jenë prezentë nga ora 09:30 deri 18:30. Sigurimi i panairit nga organizatori i panairit fillon nga ora 18:30 kur mbyllet panairi deri në orën 09:30 kur hapet përsëri. Nuk do të ketë kurrfarë kompensimi nga organizatori i panairit për mallrat apo gjërat tjera të humbura apo dëmtuara. Kompania ekspozuese mund ta bëjë sigurimin shtesë të mallrave te ndonjë kompani e sigurimeve.

**10. Energjia elektrike dhe interneti:**

Organizatori do t'i ofroj secilit ekspozues kyçje në energji elektrike 220v. Energjia mbi 220v deri në 4kw mund të ofrohet me shpenzime shtesë. Lidhja e internetit wireless ofrohet pa pagesë për ekspozuesit.

**11. Reklamimi dhe ngjarjet paralele për ekspozuesit:**

Aktivitetet promovuese mund të porositen përmes Formës së Reklamimit, të publikuar në faqen e internetit të organizatorit. Secili ekspozues mund të mbajë ngjarje paralele si: prezantime, seminare, koktej, etj, gjithmonë në marrëveshje me organizatorin. Për secilën nga këto shërbime organizatori aplikon një tarifë.

**EXPOKOS***Porta e Ballkanit!***PANAIRI NDËRKOMBËTAR**

18 - 19 Maj 2023 Prishtinë

**22  
VITE**ufi  
Approved  
Event**TERMET DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME TË PANAIRIT****12. Fotografimi dhe regjistrimi i videove:****Forma- H**

Vetëm personat apo kompanitë e autorizuara mund të ofrojnë këtë shërbim, ekspozuesit mund të bëjnë foto dhe filmime pa autorizim vetëm për stendën e tyre.

**13. Shitja e mallrave të ekspozuara:**

Mallrat e ekspozuara mund të shiten, përveç atyre mallrave që kanë hyrë në Kosovë përmes importit të përkohshëm. Për mallrat të cilat lejohen të shiten ato nuk mund të largohen nga stenda para se të përfundon panairi.

**14. Parkimi i automjeteve për ekspozuesit:**

Organizatori nuk menaxhon dhe nuk është përgjegjës për çfarëdo dëmi që eventualisht mund t'i shkaktohet automjetit në parkingjet që gjinden rreth objektit të panairit.

**15. Përgjegjësia, sigurimi:**

Menaxhmenti i panairit rekomandon që të bëhet sigurimi i ekspozateve ekspozuese – ku mund të përfshihet dërgimi dhe largimi i tyre nga panairi – dhe sigurimi i përgjegjësive nga palët e treta për lëndime trupore dhe dëme në pronë. Ekspozuesi do të jetë përgjegjës për çfarëdo dëmi në sallë, pajisje dhe stendë. Organizatori nuk mban përgjegjësi për çfarëdo dëmi material apo njerëzor.

**16. Akomodimi gjatë panairit:**

Ekspozuesit mund të kërkojnë listën e hoteleve nga organizatori ose agjencitë e udhëtimeve ose mund të kontaktojnë me hotelet drejtpërdrejt. Organizatori mund t'i ndihmojë ata duke iu ofruar informata për hotelet dhe mundësitë e akomodimit.

**17. Anulimi i ngjarjes:**

Nëse organizatori anulon ngjarjen si pasojë e ndonjë force madhore apo rrethanave tjera për të cilat nuk është përgjegjës, ai nuk mban përgjegjësi për dëmet dhe disavantazhet e shkaktuara për ekspozuesit si rezultat i anulimit të ngjarjes.

**18. Importi/eksporti i ekspozateve për panair:**

*Shpjegim: procedura e importit/eksportit të përkohshëm vlen vetëm për kompanitë ekspozuese të cilat gjatë panairit do të sjellin nga jashtë Kosove produktet apo pajisjet e tyre për ekspozim në panair.*

**Rregullat doganore të Republikës së Kosovës për importin e përkohshëm për mallrat e ekspozuara në Panair.**

**Kompanitë që do të sjellin produktet e tyre për t'i ekspozuar gjatë panairit do t'i nënshtrihen kësaj procedure:**

Duhet të përgatitni një Pro-Faturë për eksport në format të Word-it ose Excel-it, ku dërguesi-eksportuesi duhet të jetë kompania juaj, përderisa pranuesi-importuesi mund të jetë ndonjë partner i juaj në Kosovë, ose nëse nuk keni partner në Kosovë për ta bërë importin e produkteve tuaja, atëherë pranuesi-importuesi do të jetë organizatori i panairit: CEO-Congress & Event Organization, dhe këtë pro-faturë duhet ta dërgoni paraprakisht më së largu një muaj para datës së hapjes së panairit, në postën elektronike të CEO-së: info@ceokos.com.

Me këtë rast duhet të përgatitet një Garancion Bankar - Doganor për Import të përkohshëm nga Importuesi me vlerën: 29.8% të shumës totale të Profurës. Këto mjete sipas rregullave bllokohen nga Banka për një interval të caktuar kohor që në rast se malli i prezentuar në Panair nuk kthehet mbrapa - nuk eksportohet nga Kosova pas Panairit, atëherë dogana me anë të Garancionit Bankar e ka të drejtën që si mbulesë ti tërheqë mjetet nga xhirollogaria e importuesit. Ndërsa nëse respektohen rregullat e Importit të përkohshëm, që nënkupton se malli i importuar eksportohet nga Kosova brenda afatit të caktuar në Garancion Bankar që është maksimum 3 ditë pas mbylljes së Panairit, atëherë mjetet e bllokuara lirohen, dhe me këtë rast konkludohet se të dy palët i kanë respektuar rregullat e parapara me ligj sipas Doganës së Kosovës. Në rast të mos respektimit të këtyre procedurave, përgjegjësinë e bart ekspozuesi.

**Shërbimet e Bankës për garancion bankar**

100 €

**Shërbimet e kompanisë shpeditere**

150 €

**Totali****Gjithsej shërbimet e Bankës për garancion dhe të kompanisë shpeditere për import/eksport të përkohshëm -****250 €**

*Shpjegim: shpenzimet e këtyre shërbimeve duhet të paguhet paraprakisht nga kompania ekspozuese te CEO – organizatori i panairit.*

**Shembullin e formës se si duhet të jetë profatura, të dhënat e Kompanisë Shpeditere të autorizuar nga CEO, si dhe pikat kufitare në të cilat mund të hyni në Kosovë i gjeni të bashkangjitura në attachment ose në web faqen: [www.ceokos.com](http://www.ceokos.com)**

**19. Korniza ligjore në rast kontesti:**

a) Në rast se ekspozuesi tërhiqet nga pjesëmarrja në panair në afat brenda 10 ditësh pas nënshkrimit të marrëveshjes, ekspozuesi obligohet ndaj organizatorit të panairit me shumën prej 50% të shumës totale sipas marrëveshjes.

Ndërsa në rast se tërheqja bëhet 10 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes/formularit të rezervimit, ekspozuesi obligohet ndaj organizatorit të panairit me shumën totale sipas marrëveshjes.

b) Çdo mosmarrëveshje, mospajtim, ose pretendim që del nga kjo kontratë, apo është në lidhje me këtë kontratë, duke përfshirë shkeljen, ndërprerjen ose jo-vlefshmërinë e kontratës, do të zgjidhet në bazë të ligjeve në fuqi, duke ju drejtuar përmbaruesit ose në rast nevojë gjykatës kompetente në Kosovë dhe/ose gjykatës kompetente nga shteti i origjinës nga vjen kompania ekspozuese.

Organizatori mbanë të drejtën ekskluzive në përzgjedhjen e gjykatës. anës së Kosovës. Në rast të mos respektimit të këtyre procedurave, përgjegjësinë e bart ekspozuesi.